



**KËSHILLI I QARKUT SHKODËR**  
Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

**SHPALLJE PËR LEVIZJE PARALELE**

**NGRITJE NË DETYRË**

**NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe të Kreut II, III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Qarkut Shkodër shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për pozicionin:

- **Përgjegjës Sektori, Sektori Juridik, i Burimeve Njerëzore, Informacionit, Zhvillimit Social e Territorial në Këshillin e Qarkut Shkodër, Kategoria III-a/1**

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**LEVIZJE PARALELE**

**5 Maj 2017**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**NGRITJE NE DETYRE**

**12 Maj 2017**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

Përgjegjës Sektori, Sektori Juridik, i Burimeve Njerëzore, Informacionit, Zhvillimit Social e Territorial përgjigjet tek Drejtori i Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe strategjik dhe titullaret e institucionit për bashkë-rendimin e nismave dhe propozimeve për përmirësime të kuadrit ligjor dhe nënligjor, për fushat ku ushtron funksionet dhe veprimtarinë institucionale Këshilli i Qarkut Shkodër, si dhe propozon përmirësimin e procedurave administrative në arritjen e standarteve bashkëkohore në ofrimin e shërbimeve ndaj publikut, menaxhon procedurat e burimeve njerëzore në përputhje me aktet ligjore në fuqi, jep këshilla lidhur me hartimin dhe ndjekjen e zbatimit e politikave efektive të lidhura me funksionet e institucionit, të koordinimit me institucionet e nivelit të parë të qeverisjes vendore pjesë e qarkut Shkodër, institucionet qendrore sipas fushave të kompetencës institucionale që lidhen me funksionet e qarkut, si dhe të drejtimit të nëpunësve civilë të drejtorisë dhe institucionit, në përputhje me zhvillimin organizativ të drejtorisë apo institucionit për shpërndarjen e detyrave në mënyrë efektive dhe shfrytëzimin eficient të burimeve njerëzore të drejtorisë për menaxhimin e çështjeve që lidhen me kryerjen e funksioneve, me vlerësimin e performancës, me hartimin e projekt akteve dhe gjetjen e mënyrave të koordinimit sa me të dobishme, me qëllim realizimin e misioneve e funksioneve ligjore të Këshillit të Qarkut. Ndjek procedurat e duhura ligjore për hartimin, zbatimin e projekteve akteve të Kryesisë dhe Këshillit të Qarkut dhe detyra të tjera që do të caktohen sipas rregullores së brendshme të Këshillit të Qarkut Shkodër.

## I- LËVIZJA PARALELE

---

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, apo dhe kategori më të larta, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

---

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-a/1 dhe me sipër;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “*Mirë*” apo “*Shumë Mirë*”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- të zotërojnë diplomë në Shkenca Juridike si Jurist
- b- të zotërojnë diplomë të studimeve pas-universitare nivelit “*Master*” në Shkenca Ekonomike;
- c- të kenë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në administratën publike nga të cilat 2 (dy) vjet në kategorinë e mesme apo të ulët drejtuese.
- d- të kenë njohuri shumë të mira të akteve ligjore dhe nënligjore të organizimit dhe funksionimit të organeve të vetëqeverisjes vendore, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të kryerjes së shërbimeve dhe informimit të publikut.
- e- Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, zhvilluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve, aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.
- f- të kenë njohuri të gjuhës Angleze dhe Italiane.

### 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

---

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

**Dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Shkodër / Rruga “28 Nëntori” nr. 1), brenda datës 05.05.2017**

### 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

---

Në datën **05.05.2017** Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Shkoder do të shpallë në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Shkodër, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

### 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

---

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” (i ndryshuar);
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “*Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqipërisë*” (i ndryshuar);
- f- Njohuritë mbi Ligjin Nr.7776 datë 22.12.1993 “*Për buxhetin vendor*” (i ndryshuar);
- g- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” (i ndryshuar);
- h- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar;
- i- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014, “*Për të drejtën e informimit*”;

### 1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al).

**1.6**

## **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Shkodër do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2- NGRITJA NË DETYRË

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në “Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë, duke filluar nga data 19.11.2016.*

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### 2.1

## KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III-a ose III-a/1;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a- të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Juridike, dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- të kenë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në administratën publike nga të cilat 2 (dy) vjet në kategorinë e mesme apo të ulët drejtuese.
- c- të kenë njohuri shumë të mira të akteve ligjore dhe nënligjore të organizimit dhe funksionimit të organeve të vetëqeverisjes vendore, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të kryerjes së shërbimeve dhe informimit të publikut.
- d- Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, zhvilluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve, aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi;
- e- të kenë njohuri të gjuhës angleze dhe italiane.

### 2.2

## DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

**Dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Shkodër / Rruga “28 Nëntori” nr. 1), brenda datës 12.05.2017**

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Duke filluar nga data 12.05.2017, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Shkodër, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Shkodër, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

### **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);
- f- Njohuritë mbi Ligjin Nr.7776 datë 22.12.1993 “Për buxhetin vendor” (i ndryshuar);
- g- Njohuritë mbi Ligjin Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar);
- h- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar);
- i- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në **40 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **40 pikë**;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **20 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al).

**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Shkodër do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën lëvizje paralele në detyrë do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Shkodër si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Këshillit të Qarkut Shkodër si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Këshilli i Qarkut Shkodër “Rruga 28 Nëntori nr.1”, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- Për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Shkodër si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Këshilli i Qarkut Shkodër “Rruga ‘28 Nëntori’ nr.1” duke filluar nga data 19.11.2016

**NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE**